



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 03, DATË 31.01.2024

“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË BUXHETIT VENDOR, PËR FAMILJET DHE INDIVIDËT NË NEVOJË QË REZULTOJNË ME PIKË TË PAMJAFTUESHME NGA SISTEMI I PIKËZIMIT PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, pika 1, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, të Këshillit, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 31.01.2024, 2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret mbi përdorimin e fondit të buxhetit vendor për bllok-ndihmën Ekonomike si më poshtë:
 - 1.1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
 - 1.2. Do të përzgjidhen ata aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
 - 1.3 Prioritet do të kenë familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar:
 - a. familje të cilat sigurojnë të ardhura të pamjaftueshme dhe në përbërje të tyre kanë të mitur.
 - b. familje me 1 (një) anëtar,
 - c. vajza/gra kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim,
 - d. kryefamiljar që me vendim gjykate kanë në ngarkim fëmijë të mitur,
 - e. familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë, dhe në përbërje të tyre kanë të mitur.
 - f. familje të cilat kanë në përbërje të tyre persona me P.A.K, status verbërie/para-tetraplegjisë/ status invalid pune.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore (Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Shoqërore).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT
Etleva YZO

KRYETARI I KËSHILLIT
Merita SARAJ